

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Arjeta Sadiku dhe me procesmbajtësen Ganimete Hasani-Krasniqi, në konfliktin administrativ të paditësit Q. T. nga S., përfaqësuar me autorizim nga S. S. avokate nga S., kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të përfaqësueses së paditësit, me datën 6 prill 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q. T. nga S.
- II. ANULOHET** vendimi i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës në Prishtinë, **Nr. 35/012 i datës 22.10.2012** dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Paditësi përmes përfaqësueses së tij, me propozimin e datës 15 janar 2015 dhe me padinë e datës 1 shkurt 2017 si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata anulimin e vendimit të paditurës nr. 35/012 të datës 22.10.2012, me të cilin i është refuzuar ankesa dhe ka mbetur në fuqi vendimi i shkallës së parë ku i është refuzuar kërkesa për korrigjimin e të dhënave në Regjistrin themeltar të martesës. Thekson se Q. T. është i lindur me Data e lindjes... në S. nga babai M. T. dhe e ëma H. T. e lindjes K. I njëjti tek ne njihet si Q. T. për shkak të kushteve të rënda ekonomike në vitin 2002 i njëjti me qëllim që të fitoj të drejtën e daljes jashtë shtetit me saktë shkuarjes në Gjermani është paraqitur pranë shërbimit të gjendjes civile në S. me identitet të rrejshëm dhe atë si A. T. i lindur me Data e lindjes në Sh. kinse nga i ati I. dhe e ëma Xh. T. Me këto të dhëna arrin të lidhë martesë Data e lidhjes së martesës... dhe këtë dokument e përdorë si dëshmi dhe arrin të dal në Gjermani. Nga shteti gjerman ai është zënë se po punon me identitet te rrejshëm dhe nga prokuroria në qytetin Koblenz të Gjermanisë për këtë paraqitje të rreme ai ka vuajtur dënimin shërbim në komunitet 100 orë, dhe gjykatës i prezanton vërtetimin, ku dëshmohet se edhe në Gjermani statusi i tij është Q. T. I njëjti edhe në librin amzë në S. identifikohet me të njëjtin emër dhe arsye se në procedurë administrative nuk është rregulluar çështja e identitetit të tij ka qenë mungesa e shkresës zyrtare nga Gjermania të cilën ia kemi prezantuar gjykatës, prandaj i njëjti nuk po mund të rregulloj as statusin e fëmijëve të tij të cilët i ka në shënimet e tij në emrin A. T. Andaj meqenëse me ligj është përcaktuar që secili qytetar të ketë vetëm një identitet i lutemi gjykatës që të aprovojë padinë si të bazuar, ndërsa vendimin e të paditurës ta anulojë si dhe te detyrohet e paditura MPB e saktësisht Shërbimi i Gjendjes Civile

në S. që të korrigjon shënimet në dokumente personale të paditësit dhe atë duke filluar që nga certifikata e martesës dhe dokumentet personale të fëmijëve të tij duke u identifikuar Q. T. i lindur me Data e lindjes... në S.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 16.12.2016, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se vendimi është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore, nuk qëndron. Ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të merr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit në tërësi si të pabazuar.

Në seancën e datës 6 prill 2017, palët janë ftuar me rregull, mirëpo e paditura nuk ka prezentuar ndërsa mungesën e ka arsyetuar me parashtresën e datës 06.04.2017. Andaj, gjykata konform nenit 41 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), ka mbajtur shqyrtimin kryesor pa praninë e të paditurës.

Gjykata në seancën e datës 6 prill 2017 ka bërë administrimin e provave dhe atë: propozimi i paditësit i datës 15.01.2015, vendimi kontestues nr.35/012 i datës 22.10.2012, aktvendimi i të paditurës 02 nr.287 i datës 05.10.2012, ankesa e paditësit e datës 02.07.2010, deklarata nën betim DRP.nr.2558/2014 e datës 09.09.2014, certifikata e lindjes në emër të paditësit lëshuar me datën 01.10.2012, certifikata e martesës me emrin A. T. lëshuar me datën 02.12.2002, kopja e fletës nga libri amzë nr.159, kopja e fletës nga libri amzë i të martuarve nr.636 e datës 02.12.2002, kopja e letërnjoftimit në emër të paditësit lëshuar me datën 17.12.2008 nga MPB e RKS, kopja e leje qëndrimit në emër të A. T. (pa datë), kopja e pasaportës në emër të A. T. e datës 16.01.2001, njoftimi nga Prokuroria në Koblenz të Gjermanisë e datës 12.01.2009, vërtetimi i leje qëndrimit nga Qyteti Remagen i datës 05.02.2009, aktvendimi nga Gjykata Themelore në Prizren nr.4/2015 i datës 15.05.2015, përgjigja në padi e datës 16.12.2016, procesverbali mbi paraqitjen e lidhjes së kurorës në emër të A. T. nr.636 i datës 02.12.2002, certifikata për lidhje të martesës nga zyra e gjendjes civile Bashkia K. e Republikës së Sh. e datës 20.11.2002, vërtetimi nga zyra e gjendjes civile bashkësia K. e datës 20.11.2002, certifikata e lindjes në emër të H. H. e datës 11.07.2002, letërnjoftimi i lëshuar me datën 08.05.2001, vërtetimi mbi statusin martesor në emër të H. H. e datës 11.07.2002, certifikata e lindjes në emër të S. T. e datës 30.11.2004, kopjet e dokumenteve personale në emër të Z. dhe E. T. të lëshuara me datën 07.04.2014, certifikata nga Gjykata Komunale F. në emër të paditësit 11.10.2010, certifikata nga Gjykata Komunale në S. në emër të H. H. e lëshuar me datën 06.05.2004, vërtetimi nga qyteti Remagen i datës 01.06.2010, precizimi i padisë i datës 01.02.2017, si dhe vërtetimi nga Komuna S. 02/ nr.41 i datës 29.05.2015.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Për të vlerësuar kërkesëpadinë e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata fillimisht iu referua nenit 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2012-MPB për Procedurën e Korrigjimit në Regjistrat e Gjendjes Civile i aplikueshëm në kohën e paraqitjes së kërkesës nga paditësi e i cili përcakton rastet për të cilat bëhet kërkesa për korrigjim, ku në paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se:

"Nëse të dhënat e njërit regjistër nuk përputhen me të dhënat e regjistrit tjetër (lindje, martesë, vdekje), si bazë merret regjistri i të lindurve nëse është regjistrim i rregullt ose në raste tjera secili regjistrim i rregullt nga regjistrat tjerë".

Në bazë të shkresave të lëndës dhe deklaratave të palës paditëse, gjykata gjen se paditësi me rastin e kurorëzimit me bashkëshorten e tij H. H., në vitin 2002 pranë shërbimit të ofiqarisë në Komunën e S., ka përdorur identitet të rrejshëm si A. T., të cilin ka qenë duke e përdorur në shtetin gjerman me qëllim të rregullimit të statusit në këtë shtet. Çështja e përdorimit të identitetit të rremë si A. T. nga ana e paditësit Q. T. vërtetohet me vendimin e lëshuar nga Prokuroria Koblenz në Gjermani ku paditësi Q. T. është dënuar me vendim të plotfuqishëm për shkak të veprës *"noterizim indirekt i rremë, shkelje kundër ligjit për leje qëndrim"*.

Paditësi me ankesë dhe tani me padi kërkon që t'i bëhet ndryshimi i të dhënave në regjistrin themeltar të martesës, duke e harmonizuar me të dhënat në regjistrin themeltar të lindjes. Andaj në bazë të dispozitës së lartcekur një kërkesë e tillë është e pranueshme.

E paditura vendimin kontestues e arsyeton se dëshmitë e paditësit nuk kanë qenë bindëse se nuk janë të mjaftuara për të argumentuar kërkesën e tij për korrigjimin (ndryshimin) e të dhënave në regjistrin e të martuarve, prandaj ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vlerësimet nga arsyetimi i vendimit të shkallës së dytë se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga ana e organit të shkallës së parë bien në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe me dispozitat e lartëcekura. Nga ankesa e paditësit kundër vendimit të shkallës së parë, rezulton se paditësi ka vuajtur dënimin në Gjermani për shkak të paraqitjes me identitet të rremë për të cilin ka bashkangjitur vendimin e prokurorisë.

Neni 10 i Udhëzimit Administrativ nr. 01/2012-MPB për Procedurën e Korrigjimit në Regjistrat e Gjendjes Civile i cili përcakton dokumentet të cilat duhet bashkangjitur kërkesës për korrigjim, përveç tjerash në par.1.10, parasheh edhe:

"Dokument tjetër personal nga ish RSF (librezë ushtarake; librezë shëndetësore, dëshmi për pension) apo dëshmi nga shteti ku jeton pala.

E paditura nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë dokument nga shteti ku jeton pala, tani paditësi, gjegjësisht vendimin nga Prokuroria në Koblenz të Gjermanisë të datës 12.01.2009, pse i njëjti nuk ka qenë i bazuar dhe cilat prova janë konsideruar të pamjaftueshme për të përmbushur kriteret për korrigjimin e të dhënave në regjistrin themeltar të martesës.

Vendimi i kundërshtuar si i tillë është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetim nuk precizohen provat në bazë të të cilave është vendosur për ankesën e paditësit, apo cilat prova ish dashur të bashkëngjiten sipas ligjit në fuqi.

Në vendimin e atakuar nuk jepet arsyetim konkret për asnjë pretendim të paditësit dhe nuk përmendet asnjë provë e shqyrtuar në bazë të së cilës është vërtetuar ndonjë fakt, me cilat prova i ka konstatuar faktet vendimtare dhe mbi cilat dispozita ligjore është mbështetur për të ardhur te konstatimi se, nuk qëndrojnë asnjë nga pretendimet ankimore të paditësit dhe se procedura është zhvilluar konform ligjit.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, pasi që gjykata ka gjetur se ekzistojnë mospërputhje ndërmjet provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e vendimit të atakuar.

Lidhur me këtë, nga vendimi kontesues nuk mund të kuptohet si është vërtetuar fakti se paditësi nuk i plotëson kushtet për korrigjimin e të dhënave në regjistrin themeltar të martesës. Vendimin e tillë të paarsyetuar, gjykata e konsideron me të meta juridike, të cilat e pengojnë vlerësimin e

ligjshmërisë dhe të njëjtin e bëjnë të kundërligjshëm dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, të ketë parasysh dispozitat ligjore të cilat rregullojnë këtë lëmi si dhe të marrë për bazë dokumentacionin e paditësit në shkresat e lëndës dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, dhe 38 si dhe Nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.2089/15, më datë 6 prill 2017

Procesmbajtësja
Ganimete Hasani-Krasniqi

G j y q t a r j a
Arjeta Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.